

Procesverbal

*Nga Mbledhja I (e parë) e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më datë:
30.01.2024*

Rend Dite

- 1) Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
- 2) Shqyrtimi i materialit të Kuvendit për Seancën I (e parë);
- 3) Eventuale.

Arijeta Qafleshi Skeraj: Përshëndetje kryetar, përshëndetje për të gjithë! Mirë se keni ardhë në KPF-në e parë të rregullt për vitin 2024! Materialin besoj që e keni marrë të gjithë. Para se ta qesim në votim rendin e ditës, nëse ka dikush diçka rreth rendit të ditës? Nëse jo, atëherë e qesim në votim. Kush është pro këtij rendi të ditës? A ka kundër? Abstenim? 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, fillojmë me rendin e ditës. Pika e parë është miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar. A do dikush ta marrë fjalën për këtë pikë? Nëse nuk ka, kush është pro kësaj pike? Kush është kundër? Abstenim? Me 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë edhe këtë pikë. Më lejoni të filloj tash me rendin e ditës të Seancës, shqyrtimit të materialit për ditën e nesërme. Fillojmë me pikën e dytë: Propozim-vendim për ndryshimin e emrit të rrugës së lagjes "Hajdet" në "Haxhi Rrahmani". A do dikush me e marrë fjalën këtu? Nëse jo, e qesim në votim. Kush është pro? Kush është kundër? Abstenim? 5 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë këtë pikë të rendit të ditës. Pika e tretë është miratimi i Planit Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026. A do dikush me e marrë fjalën?

Lindita Kozmaqi Piraj: Përshëndetje znj.kryesuese, edhe urime udhëheqja e Komitetit të parë! Përshëndetje kryetar dhe të gjithë ju të pranishëm! E kemi Planin Lokal të Veprimit për Barazi Gjinore 2024-2026, që është përgatit nga Komuna e Dragashit, si një mjet kryesor i zbatimit të angazhimeve publike për barazinë gjinore, ku reflekton mbi Kushtetutën edhe instrumentet tjera ndërkombëtare dhe kombëtare të legjislacionit. Duke filluar nga Ligji për Barazi Gjinore, Programit për Barazi Gjinore dhe instrumenteve të BE-së, të fokusuara tek barazia si pjesë e procesit të integritimit. Ky Plan është realizuar sipas të gjithë hapave mirë të parashikuar, me një metodologji të punës të hartuar nga Grupi Punues. Grupi Punues është përgatit me vendim të kryetarit, që e kanë përfaqësuar 11 zyrtarë, duke filluar prej Qamil Kollonit, drejtorit të Financave, që është kryetar i

këtij grupi, për të vazhduar me mua, Adem Eminin, Zeni Krasniqin, Ibrahim Gashin, Liridona Misinaj, Behar Brenoli, Uzair Hamza, Fitim Kurtishi, Salmira Usmeni dhe Mimoza Berisha. Janë të gjithë këta anëtarë të këtij Grupi Punues, që janë drejtor dhe zyrtar të ndryshëm nga drejtorate të ndryshme të Komunës së Dragashit. Fillimisht është bërë analiza e situatës, të dhënat dhe informacionet ekzistuese, mandej i kemi përcaktuar fushat, i kemi mbajtur disa punëtori, objektivat që janë të përfshira të gjitha me radhë, edhe me aktivitete dhe me nënaktivitete të ndryshme, specifikisht për secilën fushë dhe për secilin objektiv. Derisa është përgatit edhe pjesa e buxhetit, që ka qenë ndoshta procesi më i stërzgjatur edhe më i rëndësishëm, sepse ka kërkuar kohë. Secili aktivitet kostohej. Këtu vlen të ceket dhe ta falënderoj në mënyrë pak më të veçantë drejtorin e Financave, z.Qamil Kolloni, për një angazhim dhe vullnetin që ka treguar në kostimin e këtij dokumenti. Paraprakisht ka qenë edhe në uebfaqen e Komunës, janë ndjek të gjitha procedurat, me një metodologji të përgatitur nga këshillat e bashkësive të rajoneve të Evropës. Rol të rëndësishëm gjatë procesit të përgatitjes ka luajtur mbështetja dhe asistenca teknike e ofruar nga UN Eomen, përmes një ekipi mirë të përgatitur dhe një konsulenteje ndërkombëtare. Ky Plan është një mjet praktik i lokalizimit të dokumentit të rëndësishëm kombëtar, por edhe ndërkombëtar, në lidhje me barazinë gjinore. Është një Plan i hartuar përmes një procesi gjithëpërfshirës, me përmbajtje në të cilën reflektohen arritjet dhe sfidat që kanë qenë për barazinë gjinore, por edhe pasqyron rolin e qartë dhe përgjegjësitë e domosdoshme për t'i përmbushë ne si Komunë, si dhe ndërmjet institucioneve lokale, apo edhe organizatave të ndryshme të shoqërisë civile, ato ndërkombëtare, me qëllim zbatimin në praktikë të parimit të barazisë për të gjithë, gratë e burrat, të rinjtë e të rejtat, vajzat e djemtë, në të gjithë diversitetin e tyre në Komunën e Dragashit. Nuk do të zgjatem shumë, dokumentin e keni pas edhe më herët në uebfaqe dhe sigurisht e keni marrë me kohë. Ndoshta mund t'i ceki vetëm objektivat, për mos me ju marrë kohë. Më tej i keni këtu të gjitha, me aktivitete, me kosto, me të gjitha. Ky Plan ka katër objektiva strategjike, duke përfshirë edhe nënobjektiva specifike, mirëpo këto katër objektiva strategjike janë: Përparimi në kuadrin e përgjithshëm të barazisë gjinore, fuqizimin e grave, të rejave dhe vajzave në të gjithë diversitetin e tyre. Kur them në të gjithë diversitetin e tyre, sigurisht e keni parasysh që Komuna jonë përbëhet prej dy e më shumë etnive, kështu që diversitetin e kemi përmend duke i përfshirë edhe komunitetet tjera që jetojnë në Dragash, përveç shqiptarëve; Është promovimi i të drejtave ekonomike, sociale dhe të punësimit të denj, si dhe fuqizimi i vajzave, të rejave dhe grave; Zvogëlimi i pabarazive gjinore në arsim, kulturë e sport, për gratë e burrat, të rejtat e të rinjtë, vajzat dhe djemtë, në të

gjithë diversitetin e tyre; dhe Promovimi i shëndetit dhe të drejtat seksuale e riprodhuese. Siç thashë, këta janë katë objektivat strategjikë, janë me tej objektivat specifike dhe aktivitetet e parapame, të cilat janë edhe të kostume. Këtu, çka deshta me theksue, rol të rëndësishëm në realizim të këtij Plani – flasim gjithmonë duke e llogarit se miratohet – në adresimin e çështjeve gjinore në nivel lokal luan edhe Grupi i Grave Asambleiste, i cili mund të llojë vazhdimisht për sigurimin e fondeve dhe zbatimin e aktiviteteve që parashihen në këtë Plan. Në vijim, të gjitha institucionet lokale, duke i përfshirë OJQ-të si partneë për zbatimin e masave dhe veprimeve konkrete të këtij Plani. Janë gjithashtu të rëndësishme sidomos për t’u pasur rezultatet e dëshiruara në përparimin drejt barazisë. Rol të rëndësishëm luajnë edhe organizatat ndërkombëtare, nëpërmjet mbështetjes së tyre financiare dhe teknike, për t’i zbatuar këto masat, të përcaktuara në këtë Plan. Kjo ishte shkurtimisht një përmbledhje që unë mendova me e nda me ju. Përndryshe, materialin e keni, në qoftë se ka diçka të paqartë, përveç meje është edhe drejtori i Financave, nesër besoj se janë të gjithë ata drejtorë të cilët i përkasin fushave dhe objektivave të këtij Plani, sepse ky është një plan komunal i barazisë gjinore, nuk është plan vetëm i zyrtarës për Barazi Gjinore. Faleminderit!

Arijeta Qafleshi Skeraj: Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë edhe e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? Kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë këtë pikë të rendit të ditës. Fillojmë me pikën tjetër: Formimi i Komisionit për ankesa për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës.

Bexhet Xheladini: E nderuar kryesuese e Kuvendit! I nderuar nënkryetar, drejtor, përfaqësues të Komitetit! I nderuar përfaqësues i OSBE-së dhe ju të tjerë të pranishëm! Ju përshëndes dhe ju falënderoj për pjesëmarrjen në Mbledhjen I të KPF-së për këtë vit! Unë menjëherë po kaloj në pikën e rendit të ditës. Nga pika e pestë e deri në pikën e gjashtëmbëdhjetë, keni propozim-vendime për shpalljen publike të lokaleve të cilët kanë qenë deri më tani në shfrytëzim nga persona të ndryshëm dhe të cilëve u ka kaluar kontrata. Kështu që, Komuna është e obliguar që përmes Asamblesë të marrë vendim që këto lokale të dalin në thirrje publike, për t’ua mundësuar njerëzve që prapë të konkurrojnë dhe t’i marrin këto në shfrytëzim. Kështu që, ne duhet që, në bazë të ligjit, së pari të propozojmë Komisionin për ankesa i cili ka vlefshmëri dyvjeçare. Unë për këtë Komision propozoj Fadil Sinanin, Rilind Tahirin dhe Orhan Tosunin OJQ “Renesansa”. Edhe, mirë është ju anëtarë të Komitetit që jeni këtu të mbani shënime, se nesër në seancë LDK-ja dhe PDK-ja duhet

ta propozojnë nga një anëtar. Nesër ju sigurisht se mbani takime para seancës, mirë është që të vini me një emër të caktuar për këtë Komision. Për mos me dalë unë shumë herë këtu, siç e keni marrë ju rendin e ditës, nga pika e pestë deri në pikën e gjashtëmbëdhjetë ka propozim-vendim edhe për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme, edhe ka propozim-vendime për formimin e komisioneve. Andaj, unë për mos me dalë shumë herë, po propozoj edhe komisionet për secilën parcelë për të cilën do të merret vendim për dhënien në shfrytëzim. Atëherë po filloj. Sa i përket pronës të 'Venezia', propozimi i ekzekutivit është: Isljam Redzeplari, Brendi Berisha dhe nga OJQ 'Avoko' Jeton Qengaj. Në Asamble duhet LDK-ja edhe PDK-ja ta paraqesin nga një anëtar të vetin. Mirë është ju me marrë shënime dhe me ardhë nesër me propozime konkrete, ose mund të propozoni edhe këtu. Te dhënia në shfrytëzim e lokalit afarist (Zyra e Avokatit), propozimi i ekzekutivit është: Isljam Redzeplari, Brendi Berisha dhe Shefkat Ismajli nga OJQ 'Zaeno za Brod'. LDK dhe VAKAT duhet ta paraqesin nga një anëtar të mundshëm të këtij Komisioni. Pastaj, te dhënia në shfrytëzim e lokalit përballë 'Mekës', propozimi i ekzekutivit është: Isljam Redzeplari, Brendi Berisha dhe Eldina Rexhepi nga OJQ 'Stars'. PDK dhe VAKAT duhet ta japin nga një anëtar. Te Byefja te Shtëpia e Kulturës: Isljam Redzeplari, Brendi Berisha dhe Nuridin Halili nga OJQ 'Guri i Zi'. LDK dhe VV duhet ta japin nga një anëtar. Te dhënia në shfrytëzim e Tregut të Gjelbër: Isljam Redzeplari, Brendi Berisha dhe Sinan nga Klubi i Shahut 'Sharri'. LDK dhe VV duhet ta japin nga një anëtar. Për Parkingun te gjykata: Isljam Redzeplari, Brendi Berisha dhe Abaz Qengaj nga OJQ 'Kroi i Maces'. PDK dhe JGP duhet ta japin nga një anëtar. Unë e kreu, tash radhën e ka kryesuesja.

Arijeta Qaflehi Skeraj: Faleminderit, kryetar! A do dikush me e marrë fjalën?

Xhemile Misinaj: Përshëndetje për të gjithë! Unë deshta me pyet në lidhje me këto propozimet. Kryetar, a mundet, për shembull, prej PDK-së veç një person me qenë në krejt këto parcelat në Komision? Apo sa herë duhet me qenë nga një person tjetër? Edhe një pyetje tjetër. Sa dëgjova, për shembull, ka shumë kombinime të partive në komisione, një herë PDK-LDK, masnej një herë VV-LDK, një herë JPG-PDK, deshta me e ditë me çfarë logjike, me çfarë matematike është vendosur? Jo, mendova mos ka ndonjë rregull fiks, që qato partitë për qet komision, e qato partitë për qet komision. Nuk e pata të qartë shumë. Okej, faleminderit!

Arijeta Qaflehi Skeraj: Faleminderit, Xhemile! Dikush tjetër a do me e marrë fjalën? Atëherë e qesim në votim. Kush është pro kësaj pike? Kush është kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero

kundër dhe zero abstenim, e kalojmë këtë pikë të rendit të ditës. Fillojmë me pikën tjetër: Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës O-70604014-10-3-2-0 ZK Dragash (Venezia). A do dikush me marrë fjalën këtu? Atëherë e hedhim në votim? Kush është pro? Kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë edhe këtë pikë. Fillojmë me pikën tjetër: Propozim-vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës O-70604014-10-3-2-0 ZK Dragash. Ky është Komisioni për lokalitetin e 'Venezias'. A do dikush me e marrë fjalën? Atëherë e hedhim në votim? Atëherë e hedhim në votim? Kush është pro? Kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë edhe këtë pikë. Fillojmë me pikën e shtatë: Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës O-70604014-10-3-1-0 ZK Dragash (Zyra e Avokatisë, ish-Pro Credit Bank). Kush do me e marrë fjalën këtu? Atëherë e hedhim në votim? Kush është pro? Kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë edhe këtë pikë. Pika e tetë është: Propozim-vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës O-70604014-10-2-2-0 ZK Dragash. A do dikush me e marrë fjalën? Atëherë e hedhim në votim? Kush është pro? Kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë edhe këtë pikë. Pika e nëntë është: Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës O-70604014-10-2-2-0 ZK Dragash (loali përballë Hotelit "MEKA"). A do dikush me e marrë fjalën?

Uran Halimi: Faleminderit, kryesuese! E mora fjalën, jo për këtë pikë të rendit të ditës, por më shqetësoi fakti i Artanit që s'po i voton këto pika të rendit të ditës që i ke sjellë ti, meqenëse ai të ka votue, kryesuese. Të ka zgjedhë, të ka mbështet që ti me e udhëheq këtë seancë. Tash pikat e tua të rendit të ditës nuk po i voton.

Artan Loshaj: Mirëmëngjes! Faleminderit, koleg! Unë sot kam vendos në mënyrë demonstrative mos me folë, se po më hakmerren pushteti. Po thojnë humë po floën. Në mënyra të tjera po më hakmerren. Përndryshe, Arijetën e kam respektue, e respektoj, e kam votue, prapë kam me e votue. Edhe, Arijeta pak është e shqetësime me një problem të vetin, e kam dashtë sot mos me e ndalë shumë këtu. Kam dashtë pak ma shpejt e shpejt me kapërcye, se si mos të foli unë këtu, s'ka kush del. E kështu, kam desht me e respektue edhe si kolege, edhe si katundarkë, edhe si një problem...e dini shumë mirë. Përndryshe, unë të kallxova, sot në mënyrë demonstrative kam vendos mos me

folë, por më detyrove. Të shohim me pushtetin çka po bëhet. Në qoftë se s'foli unë, a do të hakmerren me mu në mënyra tjera të mundshme, këta qysh dinë me u hakmarrë.

Arijeta Qafleshi Skeraj: Faleminderit, Artan! Atëherë e hedhim në votim këtë pikë të rendit të ditës. Kush është pro? Kush është kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë edhe këtë pikë. Te pika e dhjetë është: Propozim-vendim për formimin e Komisionit për vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim të pronave të paluajtshme të Komunës O-70604014-10-2-2-0 ZK Dragash. E hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë edhe këtë pikë. Kalojmë te pika e njëmbëdhjetë: Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës P-70604014-00771-0 ZK Dragash (Byfeja në Shtëpinë e Kulturës - emrin e dertanishëm "Montana"). A do dikush me e marrë fjalën këtu? Nëse jo, e hedhim në votim. Kush është pro kësaj pike? A ka kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë këtë pikë të rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e dymbëdhjetë, është e njëjta, për këtë lokal, veç për Komision. Atëherë po e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë edhe këtë pikë të rendit të ditës. Pika e trembëdhjetë është: Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-70604014-00905-1 ZK Dragash (Parkingu dhe Tregu i Gjellbër). A do dikush me e marrë fjalën këtu? Nëse s'ka, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë edhe këtë pikë. Pika e katërbëdhjetë është për Komisionin e këtij parkingut. Atëherë, drejt e në votim e qesim. Kush është për? A ka kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë edhe këtë pikë. Pika e pesëmbëdhjetë: Propozim-vendim për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-70604014-00782-2 ZK Dragash (Parkingu te Gjykata - Dragash). A do dikush me e marrë fjalën për këtë pikë? Nëse jo, e hedhim në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë edhe këtë pikë. Pika e gjashtëmbëdhjetë është Komisioni për këtë parkingun te gjykata. E hedhim edhe këtë drejt e në votim. Kush është pro? A ka kundër? Abstenim? Me 6 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e kalojmë edhe këtë pikë. Kemi mbërri te pika e fundit, pika eventuale. A do dikush me e marrë fjalën?

Artan Loshaj: znj.Kryesuese, shumë shkurt, veç deshta me e pyet ekzekutivin a janë të kënaqur sot që s'e kam folë asnjë fjalë? Edhe a po ju vjen mirë që u bë monopol këtu, domethënë hyjmë e dalim, kërkush s'folën, krejt votojmë për. Unë atë ditë, kryetar, nuk kesh i kënaqur me ty në seancën e fundit, në eventuale kur të thashë që hyni në personale shumë drejtori yt i Financave. Edhe që të thashë është mirë, pak bare një vërejtje me ia dhënë këtu, që mos me u marrë me jetën private timen. Ti jo që s'e bone atë, po për hir – se më preki shumë keq, ku s'duhet me prek – s'kanë shkue 24 orë, pa emra, e dini shumë mirë, ju lutem, një herë ju kam thënë, s'po due me rrit veten, mos më boni probleme – probleme, s'un më boni probleme – mos më boni diqysh si dhunë psiqike, psikologjike, me do pozita tjera, nëpër puna tjera, në jetën private. Po ju lutem, si shok, si prind, si familjar, më lini rahat në jetën teme. Në Kuvend, çka keni me folë, në Kuvend qitne në politikë, mos e qitni në personale në jetën private edhe mos u merrni masi të dalim prej këtu, me ata shefat e juaj. S'po due, s'po due edhe një herë, ta shohim ku jemi edhe këtë muaj, po të lutem, ma mirë ndali do sende, se s'është mirë. S'është mirë as për ju, as për mu.

Arijeta Qafleshi Skeraj: Faleminderit, Artan! A do dikush tjetër me e marrë fjalën?

Uran Halimi: Faleminderit, kryesuese! Të nderum të pranishëm! Po ndërlihem pak me kolegun që foli paraprakisht. S'po më pëlqen që është mirë me u dorëzue, Artan. Është mirë me vazhdue. Pika e parë që po due me e cek, meqenëse jemi në sezonin e dimrit, është pastrimi i rrugëve nga bora. Prapë ata traktoristët janë mundue me të veten, të shkretit, për me pasture rrugën. Mirëpo, në shumicën e rrugëve, ata nuk i kanë pastrue, veç e kanë shkelë borën. Kisha propozue që, në vend të traktorëve me ua ble nga një valak këtyre traktoristëve, edhe le të dalin ta shkelin veç. I keni pa, rrugët janë të papastra edhe komplet me ngrica, me akullnaja, sidomos rruga e Brrutit e lidhur me Trokanin atje, rruga e fushës së Zgatarit – erdha sot qanej bile – është goxha e papastrume. Duhet me e ditë që kemi punëtore edhe të gjinisë femrore që vozisin. Është goxha telashe kalimi, sidomos rruga Blaç – Zgatar. Është mirë me dalë me i pastrue me kohë, që mos me i shkelë ato bora edhe m'u bo akullnaja. Mandej, kryetar, e kemi një pakënaqësi të kryesisë së fshatit Zgatar. S'e di a je i informum që ata kanë dhënë dorëheqje edhe arsyeja e vetme u konë moskoordinimi me pushtetin lokal. Ata kanë dhënë arsye që po japim dorëheqje vetëm pse qeverisja komunale as nuk i pyet, e as nuk i përfill, sa i përket investimeve kapitale në fshatin Zgatar. Ankesat tjera, unë te eventualja zakonisht kam vendos me i pru ankesat e qytetarëve, i nderum kryetar. Keni folë për harxhimin e buxhetit në vlerë prej 97%. Ajo që më ka rënë në sy edhe kam dëgju, se në harxhimin e buxhetit

deri në këtë masë marrin pjesë edhe mëditjet e punëtorëve komunalë, të cilët kanë marrë mëditje edhe të dielave, po edhe gjatë pushimeve vjetore. Mandej një pyetje tjetër. Për vitin 2024, kryetar, a keni me i vazhduar subvencionimet e OJQ-ve, prapë ka dy herë për të njëjtin aktivitet, domethënë dy OJQ për të njëjtin aktivitet, siç ishte praktika e vitit të kaluar. Këto përgjigje nëse mundesh me m'i dhënë, mirë kishe bo. Faleminderit, kryesuese!

Bexhet Xheladini: Sa i përket Artanit – megjithëse s'është këtu, por po i përgjigjem – nuk kam kurrfarë njohurie dhe nuk jam në temë edhe nuk e di çka tha, edhe çka pyeti, e për çka e kishte fjalën. Nëse ai ka ndonjë argument, le të vjen në zyrë, mujm me bisedue, por përndryshe as nuk e di se për çka është fjala. Uran, sa i përket pastrimit të rrugëve nga bora, unë po flas për këtë herën e fundit, borëpastruesit kanë qenë në nivel dhe 99.9% të rruëve janë pastrue. Edhe 99.9% nuk kemi pas ankesa, vetëm lavdata edhe mirënjohje nga popullata. Sa i përket ngricave, ne nuk kemi mekanizëm për qitjen e kripës, ne e kemi vetëm mekanizmin e hapjes së rrugëve nga bora. Sa i përket kryesisë së fshatit Zgatar, unë për herë të parë po dëgjoj që kryesia e fshatit Zgatar ka dhënë dorëheqje. Kryesia e fshatit Zgatar asnjë komunikim nuk e ka pas me mu, absolutisht, as ndonjë kënaqësi, as ndonjë pakënaqësi. As nuk kanë qenë në takim me mu, me tregue pse kanë dhënë dorëheqje. Unë këtë nuk e di, unë e mësova prej jush, nuk e di a është e vërtetë kjo a s'është, po mbetet me e vërtetue. Edhe për atë OJQ-në, nuk të kuptova, çka është puna? Për cilën OJQ e ke fjalën? Të pastrimit nga bora, apo OJQ që po marrin këso projekte? Për atë ka vendos Komisioni i formuar për këtë çështje. Nëse ka ndonjë shkelje, ekziston prokuroria, gjykata, çoje lëndën. Nuk e di, unë nuk e kam edhe këtë njohuri nuk e kam, unë e di që çdo gjë ka qenë në rregull.

Uran Halimi: Tash e di, kryetar, që je marak me qeveris prej Facebook-it aty, me hulumtue. Bile të kisha zgjedhë kryetar i llajkave, në fakt qeverisje e llajkave, se i hulumtoni shumë mirë lavdatat. Unë fola për diçka që na e ecim, një rrugë që na e kalojmë. Krejt qytetarët e ecin atë. Edhe nëse ata të japin lavdata me qato rrugë, sidomos për këto që i përmenda, atëherë po i bjer që unë kam ndonjë inat personal. Po nuk ekziston kjo. Rrugën edhe tash me shkue, edhe pse kanë kalue ma shumë se një javë, sidomos ajo e Brrutit në Trokan edhe e Zgatarit, është kiamet rrugë, s'i thuesh rrugë, është mirë mos me e ec bile atë. Bëne një komunikatë, thuaj mos e ecni qytetarë, se është rrezik. Sa i përket dorëheqjes së kryesisë, edhe këtë e dish kryetar, se Facebook-in ti e përcjellish shumë mirë edhe u konë e shpërndame te ato faqet e Zgatarit. Po më pëlqen kur po e luan të padijshmin ndonjëherë, je aktor i mirë. Mandej e ke edhe traktoristin e Blaçit, se edhe atij i ke

thënë s' di kurgjo valla, prapë s' e keni marrë në punë atë traktoristin që i çelën rrugët shumë mirë. Me të vetmin arsytim se ka bërë llajka në statuse të VV-së. Të ulëta janë këto arsytime. Merrni punëtor hakikat, shtini edhe do që s' dinë me e dhezë traktorin, po ata që janë merituar merrni më shumë vëllë, se ma mirë është për ju, ju del faqja e bardhë. Mos bëni inate politike për llajka në Facebook, se janë të ulëta. Një qeverisje komunale me u marrë me llajka në Facebook, atëherë që doni unë po e msheli krejt profilin në Facebook, mos iu hakmerrni njerëzve për llajka pa nevojë. Me të vërtetë janë të ulëta këto. Një traktorist shembullor që ka kontribue me dekada – me dekada ka kontribue Beka i Blaçit, me pajisjet e veta, e di edhe Kerimi këtu që është i Blaçit, mundën me e pohue – me pajisje të veta, asnjëherë kompensim s'ka lyp, qysh po i kompenson disa kompani private, ose individë me një 100 litër naftë. Beka as 100 litër naftë s' i ka marrë ndonjëherë. I ke thënë atij unë s' e di që s' të kanë marrë, që sot po informohem. Qe sot po të informoj prapë që s' e kanë marrë. Hë, thuj që s' e dish prapë! Shfrytëzoji njerëzit që kanë vlera, për të mirën tënde dhe të qytetarëve. Inatin personal me e pague qytetarët s' bën, kryetar. Atë llajkin e atij që e ka bo diku, po e pagun qytetari. Këtu është esenca. Faleminderit!

Arijeta Qafleshi Skeraj: Faleminderit, Uran! A do dikush me e marrë fjalën? Atëherë, e mbyllim këtë Komitet! Shihemi nesër në seancë! Faleminderit!

Kryesuese e KPF-së

Arijeta Qafleshi Skeraj